



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës Arbëneshja Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së PER: <i>[Signature]</i> Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erblin Hetemi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor MAPL	Datë: 21.10.2025
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit	VI-020-576
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor		
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës së Gjakovës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullosës (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 01-011/01-51390 për miratimin e Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Gjakovës 2026-2029
I miratuar më datë: 25.09.2025
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 30.09.2025

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Gjakovës në mbledhjen e mbajtur me datë 25.09.2025, ka miratuar Vendimin Nr. 01-011/01-51390 për miratimin e Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Gjakovës 2026-2029.

MAPL konstaton se Vendimi Nr. 01-011/01-51390 për miratimin e Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Gjakovës 2026-2029, përkatësisht shtojca tabelore e Planit të Veprimit për Transparencë, afati 15 ditor i vlerësimit të ligjshmërisë nga ministria përgjegjëse duhet të harmonizohet me nenin 9 paragrafin 3 të Ligjit Nr.08/L-284 për shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.

Andaj bazuar në të lartcekurat, Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duhet të ndërmerri veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E GJAKOVËS
 OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica - Municipality of Gjakova

ARKIVA DALËSE
 IZLAZNE ARHIVE
 OUTPUT ARCHIVES

Nr. Inv/Br. Inv. 01-011/01-51390
 Nr.faqeve/Str./No.Pg. 1
 Data/Datum/Date 26.09.2025

Kuvendi i Komunës - Gjakovë

01 Nr. /2025

Dt.25.09.2025

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, bazuar në nenin 12 dhe 68, par. 4 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe nenin 15 të Statutit të Komunës së Gjakovës 01nr.110/04-29365 të datës 30.12.2022, në nenit 42 par. 1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, në mbledhjen e mbajtur me datë 25.09.2025, pas diskutimeve lidhur më pikën e 5 të rendit të ditës: Shqyrtimi i Draft Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Gjakovës 2026-2029, e miratoj këtë:

V E N D I M

Për

Miratimin

e Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Gjakovës 2026-2029.

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës miraton Planin e Veprimit për Transparencë në Komunën e Gjakovës 2026-2029.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i Veprimit të Komunës së Gjakovës për Transparencë në Komunën e Gjakovës 2026-2029.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës .
4. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Zyrës për Informim.
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës,
 - Arkivit,

Arbëneshja Kuçi
 Kryesuesja e Kuvendit të Komunës